



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 26.08.2024

Nr: 19

Ora: 12:30

VENDIM
PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 11, DATË 09.08.2024 DEPOZITUAR NGA
KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.08.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni Bashkë Fitojmë, përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe z. Vangjel Dule

PALË E INTERESUAR: z. Vangjel Tavo, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga z. Eridjan Saliانji

OBJEKT:

1. Kundërshtimin e vendimit nr. 85, datë 05.08.2024 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024”, të KZAZ nr. 88;
2. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV (gjithësej 36 QV-të) të zonës zgjedhore, bashkia Himarë;
3. Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve për bashkinë Himarë.

Data: 26.08.2024 Nr: 19
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 11, datë 09.08.2024 depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “c”, neni 123/1 dhe pika 3, e neni 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 244, datë 05.07.2024, caktoi datën 04 gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.
2. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, pasi shqyrtoi procesin e nxjerrjes së rezultateve për 36 QV, pasqyroi rezultatet e të dhënave respektive për çdo QV mbi bazën e tabelave origjinale të rezultateve të GNV-ve. Në përfundim të këtij procesi, KZAZ nr. 88, Qarku Vlorë nëpërmjet vendimit nr. 85, datë 05.08.2024, vendosi të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë dhe të shpallë fitues z. Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
3. Kundër vendimit nr. 85, datë 05.08.2024 “Për miratimin e tabelës e përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Himarë”, të KZAZ-së nr. 88, qarku Vlorë, ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha Qendrat e Votimit (gjithsej 36 QV-të) e zonës zgjedhore Bashkia Himarë, si dhe rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Himarë dhe përsëritjen e tyre.
4. Kërkesa ankimore nr. 11, iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim, me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit më datë 21.08.2024, ora 12:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar me autorizim nga z. Marisold Bardhi, me detyrë Jurist, përfaqësuesi i palës ankimuese, z. Franci Nuri dhe z. Vangjel Dule, si dhe përfaqësuesi i palës së interesuar, z. Eridjan Salianji.
5. Përfaqësuesi në seancë i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Franci Nuri pretendoi në ankim se ka patur parregullësi në kundërshtim me ligjin, duke parashtruar se:
 - *Diferenca midis kandidatëve sipas tabelës përmbledhëse rezultoi rreth 1470 vota;*
 - *Nga kryqëzimi i provave dhe i të dhënave, problemi madhor në zgjedhjet e 4 Gushtit në Himarë ishte pamundësimi i votimit i mbi 26% të listës së zgjedhësve, ose i 6.157 zgjedhës të regjistruar në listat zgjedhore nga rreth 23.500 zgjedhës në total. Kjo pengesë për të votuar, në vlerësojmë se është e paligjshme pasi në zgjedhje të mëparshme, qeveria, me akte rregullatore, ka zgjatur afatin e vlefshmërisë së këtyre dokumanteve dhe këta zgjedhës kanë pasur mundësi të votojnë;*
 - *256 raste të evidentuara nga provat, ku zgjedhës të caktuar kishin arritur të rinovonin kartat e tyre në kohë rekord, duke i marrë ato 1 apo 2 ditë para 4 Gushtit, aq sa pajisja PEI nuk i njihite për shkak të mos-përditësimit të sistemit me të dhënat e fundit;*

- Nga të dhënat dhe provat që arritëm të analizojmë, figurojnë rreth 560 zgjedhës që janë penguar të votojnë, për shkak të skadencës së dokumenteve;
 - Nga të dhënat dhe provat që arritëm të analizojmë, figurojnë 311 zgjedhës të shtuar në Himarë nga Prilli 2023, deri në Qershor 2024, ndërsa nga dita e dekretimit të zgjedhjeve, deri në mbylljen e fushatës janë përlogaritur rreth 93 zgjedhës të tjerë që janë zhvendosur nga bashki të tjera në drejtim të Himarës me “letra” për të votuar;
 - Si rezultat, të paktën 1.438 zgjedhës rezultojnë se kanë patur probleme duke u identifikuar gabimisht – Pra 17% e totalit të votuesve. Një numër tepër i lartë krahasuar me shifren e 8.500 votuesve në total në këtë Bashki në 4 Gusht;
 - Nga të dhënat figurojnë 388 zgjedhës me verifikim pa shenja të gishtit.
6. Ankuesi, në seancën e shqyrtimit të datës 21.08.2024, bazuar në një kërkesë të depozituar pranë KQZ në datë 12.08.2024, kërkoi fillimisht marrjen e provave shkresore pranë KQZ, të cilat disponoheshin nga administrata e KQZ-së, por që nuk i ishin vënë në dispozicion përpara zhvillimit të seancës së shqyrtimit administrativ në KAS, duke arsyetuar domosdoshmërinë e provave shkresore në mbështetje të pretendimeve të tij. Në përfundim të diskutimit për administrimin e provave, pala ankimuese kërkoi kohë për njohjen me to.
7. Gjatë seancës të datës 22.08.2024, pala ankimuese në parashtrimet e tij të çështjes, kërkoi që të hapeshin kutitë e materialeve të votimit për të këqyruar dhe administruar kopje të provave dhe konkretisht të:
- Librit të Protokollit të Mbledhjeve për çdo qendër votimi;
 - Regjistrin të Posaçëm të Zgjedhësve për çdo qendër votimi;
 - Listës së zgjedhësve për çdo qendër votimi; dhe
 - Procesverbalit të mbylljes së votimit për çdo qendër votimi (KQZ-00-08).
8. Sipas palës ankimuese, këqyrja e këtyre provave do të orientonte kërkesën e tyre për pavlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve sipas përcaktimeve të neneve 124, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, për të vlerësuar nëse ka pasur ndikim në ndarjen e mandateve numri i zgjedhësve që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit, është i barabartë ose më i madh se diferenca e votave të kandidatit fitues.
9. Pas rrëzimit me shumicë votash nga KAS të kësaj kërkesë procedurale të ankimuesit, me kërkesë të dy anetarëve të KAS, në mbështetje të nenit 21 pika 2 të Kodit Zgjedhor, u vendos këqyrja e provave dhe administrimi i kopjeve të kërkuara nga ankuesi të gjendura në kutitë e materialeve zgjedhore. Po në datë 22.08.2024, në ambientet e KQZ-së, filloi procesi i këqyrjes së provave për 36 QV-të e bashkisë Himarë. Procesi i hapjes së kutive të materialeve zgjedhore u krye në praninë e të gjithë pjesëmarrësve, duke garantuar transparencën e procesit.
10. Grupet verifikuan për çdo kuti të hapur përmbajtjen e dokumentacionit të kërkuar nga dy anëtarët e KAS në prezencë të palës ankimuese, për të evidentuar rastet ku janë shënuar vendimmarrje / apo të dhëna të tjera që mundësojnë identifikimin e rasteve për moslejimin e zgjedhësve për të votuar për shkak se janë paraqitur në qendrën e votimit me dokument identifikimi të skaduar / të pavlefshëm.

11. Gjatë këqyrjes së provave të kërkuara nga pala ankimuese që gjendeshin në kutitë e materialeve zgjedhore për 36 qendrat e votimit, nga administrata e KQZ u evidentuan disa raste ku zgjedhësit janë ndaluar të votojnë për shkak të letërnjoftimeve të skaduar (afati i tejkaluar i vlefshmërisë së tyre) dhe problemeve me identifikimin përmes sistemit elektronik.
- Nga shqyrtimi i Librit të Protokollit të Mbledhjeve të të gjitha qendrave të votimit të kësaj KZAZ-je, rezultoi se në 11 qendra votimi janë regjistruar 23 raste ku zgjedhësit nuk janë lejuar të votojnë për shkak se kanë qënë të pajisur me letërnjoftime tej afatit të vlefshmërisë së tyre;
 - Gjithashtu, në 3 qendra votimi janë evidentuar 128 zgjedhës me letërnjoftime tej afatit të vlefshmërisë së tyre që janë evidentuar në Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve dhe nuk janë lejuar të votojnë;
 - Ndërkohë, në librin e protokollit të mbledhjeve të 22 qendrave të votimit, janë evidentuar rreth 165 raste ku zgjedhësit kishin vështirësi identifikimi përmes pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI), për shkak të mosleximit të shenjave të gishtit/gishtërinjve, por nuk është evidentuar ndonjë rast ku zgjedhësit me letërnjoftime të reja nuk janë lejuar të votojnë për shkak të mosnjohjes nga sistemi;
 - Në 8 qendra votimi janë evidentuar 37 zgjedhës në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve si komisionerë/ administratë zgjedhore. Ndërkohë nga lista e zgjedhësve dhe procesverbali i mbylljes së votimit nuk ka të dhëna për pretendimet e kërkuara.
12. Më datë 26.08.2024, KAS riçeli seancën e shqyrtimit administrativ lidhur me plotësimin e kërkesës së ankuesit të mbështetur nga dy anëtarë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të gjetur në kutitë e materialeve zgjedhore, si dhe shqyrtimin dhe paraqitjen e konkluzioneve. Përfaqësuesi i palës ankimuese nuk ka paraqitur asnjë vërejtje / pretendim lidhur me provat.
13. Në përfundim, pala ankimuese pretendoi se fakti që e drejta për të votuar ju është mohuar 6157 zgjedhësve të regjistruar në listën e zgjedhësve, që përbëjnë rreth 26% të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore, ka cënuar parimin e sigurisë juridike dhe asaj të barazisë së votës, sipas argumentimeve të dhëna në parashtrimet e saj.
14. Pala e interesuar e përfaqësuar nga z. Eridjan Saliari, pretendoi se ankimi nuk është i mbështetur në prova dhe fakte, për shkak se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka kërkuar pavlefshmëri për asnjë qendër specifike votimi.
15. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
- Kërkesën Ankimore nr. 11 të depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”;
 - Vendimin nr. 85, datë 05.08.2024 “Për miratimin e tabelës e përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Himarë”, të KZAZ-së nr. 88, qarku Vlorë;
 - Shkresën me nr. 2450 prot., datë 13.08.2024, me lëndë “Kërkesë lidhur me procesin zgjedhor të datës 04 Gusht 2024 në bashkinë Himarë”, depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”;
 - Librin e Protokollit të Mbledhjeve për çdo qendër votimi;

- Regjistrin e posaçëm të zgjedhësve për çdo qendër votimi; dhe
- Procesverbalin e mbylljes së votimit të çdo qendre votimi (KQZ-00-08).

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi se:

1. Kërkesa për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve duke konsideruar pasojën serioze që sjell, përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, gjen rregullim të posaçëm ligjor dhe shterues në Kodin Zgjedhor. Neni 160 i këtij kodi përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:
 - a) *shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;*
 - b) *fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose*
 - c) *mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.*

Në rastin konkret, ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore duke e kërkuar shpalljen e saj në tërësi, pa evidentuar raste për qendra votimi specifike. Referuar kërkesës ankimore dhe pretendimeve të palës ankimesi, kjo pavlefshmëri pretendohet në kuptim të nenit 160 shkronja “a” të K.Zgjedhor, ndaj nuk është rast që të vlerësohet pavlefshmëria në kuptim të shkronjave “b” dhe “c” të këtij neni.

2. Në vlerësim të praktikës gjyqësore të konsoliduar tashmë në lidhje me institutin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor në disa vendime ka analizuar shkaqet ligjore dhe rrethanat faktike që do shkaktonin pavlefshmërinë e zgjedhjeve duke përcaktuar midis të tjerash se: *“Subjektet zgjedhore gëzojnë të drejtën për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi duke paraqitur shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre. Kolegji vë në dukje se në interpretim të nenit 160 paragrafi I germa "a" të Kodit Zgjedhor, në rastet e kërkesës për shpallje të pavlefshme të zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, vlerësimi i "shkeljes" duhet berë nisur nga kritere objektive. Në këtë drejtim, Kolegji thekson se në kuptim të nenit 169 pika I germa "a" të Kodit Zgjedhor, subjekti zgjedhor ankues duhet a) të evidentojë veprimeve apo mosveprimeve, të cilat pretendohen si shkelje të ligjit; b) të provojë ekzistencën e shkeljeve të pretenduara; si dhe c) të provojë lidhjen shkakësore midis shkeljes së pretenduar dhe pasojës, cënimit të rëndë të procesit zgjedhor”.*¹
3. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që

¹ Vendimi i Kolegjit Zgjedhor nr. 11, datë.04.06.2021, paragrafi 18

të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

4. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave *“për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”*.
5. Në rastin konkret, ankuesi pretendoi pamundësinë për të siguruar dokumentacionin që provonte shkeljen e pretenduar dhe nga administrata e KQZ fillimisht ju dhanë kopje të të gjitha akteve të kërkuara që disponoheshin nga KQZ dhe në vijim nga KAS më mjetin procedural që disponon, u hapën kutitë e materialeve zgjedhore duke i vendosur në dispozicion të gjitha provat shkresore që u kërkuan. Pavarësisht administrimit të çdo prove të kërkuar nga ankuesi, në përfundim të shqyrtimit të provave, nuk u paraqit asnjë arsyetim ligjor dhe analizë provash që *“të evidentojë veprimeve apo mosveprimeve, të cilat pretendohen si shkelje të ligjit”*. Madje vetë pala ankuese nuk bazoi asnjë pretendim të sajën në prova të administruara gjatë shqyrtimit administrativ, por vetëm në pretendimet fillestare të pambështetura në ndonjë provë konkrete.
6. Ankuesi, në kërkesën akimore dhe gjatë shqyrtimit administrativ, pretendoi se në këto zgjedhje të pjesshme *pamundësimi i votimit të 6.157 zgjedhësve të regjistruar në listat zgjedhore për shkak të tejkallimit të afatit të vlefshmërisë të dokumenteve të identifikimit, është shkak për pavleshmerinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, duke ngritur pretendimin mbështetës se rreth 500 zgjedhës që kanë dashur të votojnë u është ndërprerë procesi për shkak se pajisja PEI ka evidentuar dokumentet me afat të tejkalluar.*
7. Neni 105 i Kodit zgjedhor përcakton se zgjedhësi *paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike, si më poshtë: i) letërnjoftim; ose ii) pasaportë*. Ky rregullim ligjor nuk lejon diskrecion për anëtarët apo Komisionin e QV-së dhe është zbatuar me përpikmëri në 36 qendrat e votimit të Bashkisë Himarë, si dhe nga KZAZ-së në ditët e votimit. Për më tepër edhe nëse do të pranohej fakti që KQV ka diskrecion në lidhje me çështjen e afatit të vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit, referuar formulës së përbërjes së KQV-ve, ku në gjysmën e tyre (18 QV), shumica e anëtarëve të KQV kanë qenë të propzuar nga vetë ankimuesi, këta të fundit nuk kanë ndërmarrë asnjë vendimmarrje për të lejuar zgjedhës me dokumente identifikimi tej afatit të vlefshmërisë së tyre për të votuar.
8. Zgjatja e vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit, në rastet e zgjedhjeve të përgjithshme apo vendore në gjithë vendin, është kryer me ndryshime ligjore² dhe moszbatimi i të njëjtit standard për zgjedhjet e pjesshme në Himarë apo në raste të tjera të ngjashme (zgjedhjet e pjesshme për bashkinë Kukës 24.09.2023), është diskrecion i ligjvënësit dhe si i tillë nuk mund

² Në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar

të jetë objekt i këtij shqyrtimi administrativ. Për më tepër, në lidhje me këtë argument, vlen të theksohet se nga shqyrtimi i provave të administruara në kutitë e materialeve zgjedhore, rezultuan vetëm 169 raste kur pajisja PEI kishte identifikuar persona me dokumente identifikimi, afati i vlefshmërisë i të cilave kishte kaluar, përkundër pretendimit të ankuesit për rreth 560 raste të tilla. Projektioni hipotetik i ankimuesit se shifra prej 169 rastesh të zgjedhësve të paraqitur në 36 QV me dokumente identifikimi tej afatit të vlefshmërisë së tyre, është e tillë që kalon diferencën prej 1477 votash (diferenca mes dy kandidatëve), mbetet vetëm hipotetike dhe e pabazuar në asnjë provë, për më tepër që në zgjedhjet e datës 4 gusht 2024, pjesëmarrja e votuesve (8692) ka qenë më e lartë se në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 (7821). Ky argument i palës ankimuese, në lidhje me projektionin hipotetik të pamundësisë së zgjedhësve për të votuar për shkak të afatit të vlefshmërisë të dokumentit, do të kishte vlerë argumentuese vetëm nëse pjesëmarrja në zgjedhjet e datës 4 gusht 2024 do të ishte anomalisht më e ulët se pjesëmarrja në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

9. Ndodhur në këto kushte, për aq kohë sa:

- Vetë KZAZ (në shumicë të saj ka pasur anëtarë të propozuar nga ankuesi) nuk ka ndërmarrë ndonjë procedurë vendimmarrje për rastet e zgjedhësve që do të paraqiten në QV me dokumente identifikimi me afat tej vlefshmërisë së tyre;
- 18 KQV (në shumicë të tyre kanë pasur anëtarë të propozuar nga ankuesi) po ashtu si KZAZ nuk kanë ndërmarrë ndonjë procedurë vendimmarrje për rastet e zgjedhësve që janë paraqitur në QV me dokumente identifikimi me afat tej vlefshmërisë së tyre;
- Nuk është dhënë asnjë argument në lidhje me faktin se pse jemi në kushtet e shkeljes së ligjit kur zgjedhësve me dokument identifikimi tej afatit të vlefshmërisë së tyre ju është mohuar e drejta për të votuar;
- Statistikisht nuk është provuar që numri i votuesve që janë paraqitur për të votuar me dokument identifikimi tej afatit të vlefshmërisë të përcaktuar në vetë dokumentin përkatës, të jetë më shumë se 169; dhe
- Numri i votuesve në zgjedhjet e datës 4 gusht 2024 është më i madh se numri i votuesve në datën 14 maj 2023;

atëherë nuk provohet që në lidhje me këtë fakt (pamundësinë për të votuar), të këtë pasur shkelje ligji, e cila të këtë cënuar rëndë procesin zgjedhor aq më tepër në një masë të tillë, që mund të këtë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, siç kërkohet nga neni 160 pika 1 shkronja “a” e K.Zgjedhor.

10. Pretendimi i ankuesit se në disa raste të paspecifikuara janë lejuar dhe kanë votuar në mënyrë preferenciale shtetas me dokumenta identifikimi afati i vlefshmërisë i të cilave kishte kaluar, u rrëzua nga këqyrja e dokumentacionit të administruar nga hapja e kutive të materialeve zgjedhore për 36 qendrat e votimit, pasi nuk u evidentua anjë rast apo shënime të paleve në proces.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 11, datë 09.08.2024 depozituar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 85, datë 05.08.2024, të KZAZ nr. 88, Qarku Vlorë “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor

U shpall sot me datë 26.08.2024

Koli	BELE	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar